



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.15.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AGJENCISË SHTETËRORE PËR
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi pasqyrat vjetore financiare të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e te Dhënave Personale në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga, Hysen Boqolli (Udhëheqës Ekipi), dhe Vlora Duraku

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	10
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	11
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	20
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Mbikëqyrësin Kryesor Shtetëror dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në memon e planifikimit të auditimit, e datës 02 dhjetor 2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyrat vjetore financiare të theksuara në memon e planifikimit të auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (**ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar**).

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij draft-raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka monitoruar adresimin e rekomandimeve të dhëna në vitin 2012 dhe ka bërë një progres në këtë drejtim. Megjithatë, rekomandimet e pa adresuara vazhdojnë të kenë ndikim në fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Kjo paraqet nevojën për veprime shtesë, deri në adresimin e plotë për të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit janë mira. Realizimi i buxhetit ishte në një nivel të arsyeshëm, në të gjitha kategoritë ekonomike.

Megjithatë, kontrollet mbi një serë fushash përfshirë menaxhimin dhe raportimin e shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm. Theks i veçante, duhet të vihet klasifikimit të shpenzimeve sipas kategorive dhe raportimit të jashtëm.

Ndërsa nga aspekti i rëndësisë me të ulët, kontrolle shtesë nevojiten në menaxhimin e procesit të pagesave si dhe në menaxhimin e personelit.

Rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm janë si në vijim:

Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se:

- Janë përmbushur të gjitha kërkesat e raportimit të jashtëm të cilat kërkojnë me Legjislacionin në fuqi;
- Plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar, dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Menaxhmenti në baza të rregullta;
- Me rastin e planifikimit të buxhetit, janë bërë analiza të hollësishme dhe janë identifikuar nevojat reale për shpenzime, përfshirë edhe kategorizimin e tyre. Me tutje, të siguroj se të gjitha shpenzimet janë regjistruara në kategoritë ekonomike adekuate; si dhe
- Janë forcuar kontrollet mbi menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, përfshirë azhurnimin e vazhdueshëm të regjistrit kontabël të pasurisë si dhe funksionalizimin e programit E-pasuria.

Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP) të përgatisë pasqyrat vjetore financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallen deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti kishte adresuar rekomandimeve e bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat vjetore financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

PVF-të e ASHMDHP-së janë në pajtueshmëri të plotë me Rregullën financiare nr. 03/2013 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore, dhe të njëjtat janë në pajtim me kërkesat e raportimit financiar në bazë të parimit të kontabilitetit të parasë së gatshme.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (**ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar**).

¹ Termi „opinion i pamodifikuar” është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar” i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 dhe ndryshim plotësimet e tij;
- Kërkesat e rregullores 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike dhe rregullores të Ministrisë Financave (MF)-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore;
- Nëse PVF-të, janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF; dhe
- Nëse PVF-të janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike.

ASHMDHP nuk kishte arritur të përgatiste dhe të dorëzonte PVF-të në MF. Në maj të vitit 2014, ne kemi kërkuar nga ky Institucion të përgatisë dhe dorëzoj PVF-të. Pas kërkesës tonë ata kanë përgatitur dhe dorëzuar PVF-të në ZAP për qëllime të auditimit. Megjithatë për shkak të vonesave ato nuk ishin dorëzuar në MF.

Ne nuk kemi ndonjë çështje tjetër lidhur me kërkesat e lartcekura.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrimi

Përveç hartimit të PVF-ve, ASHMDHP ka adresuar obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raporti vjetor i punës (përformancës) për vitin 2013;
- Planin e rrjedhjes së parasë; dhe
- Planin e Veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Megjithatë ASHMDHP nuk ka arritur të dorëzojë të gjitha kërkesat për raportim të jashtëm.

Çështja 1 - Raportim jo i plotë i ASHMDHP-së - Prioritet i lartë

E gjetura	Raportet të cilat nuk kanë arritur të dorëzohen në MF janë si në vijim: <ul style="list-style-type: none">• Raportet mujore të obligimeve (faturave) të papaguara në;• Raporti i vetëvlerësimit për menaxhimin financiar dhe kontrollet;• Raportet tremujore të barazimeve; dhe• Planin fillestar i prokurimit.
Rreziku	Mos përmbushja e obligimeve për raportim të jashtëm cenon kërkesat e llogaridhënies dhe të transparencës si dhe rrezikon që kontrolli dhe mbikëqyrja realizimit të buxhetit të jetë i dobët.
Rekomandimi 1	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë përmbushjen e obligimeve të llogaridhënies dhe transparencës përmes raportimit të rregullte dhe me kohë në përputhje me kornizën ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrolle.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Në aspektin e adresimit të rekomandimeve, shihet një progres i lehtë nga ana e Menaxhmentit të ASHMDHP-së, mirëpo kjo nuk është e mjaftueshme në raport me kërkesat e auditimit.

Numri i rekomandimeve të pa adresuara tregon nevojën që Menaxhmenti, të përgatitë një plan me të qartë të veprimit dhe monitorim të rregulltë të tij për të adresuar të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të ASHMDHP ka rezultuar në 14 rekomandime. ASHMDHP kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2013, tetë rekomandime ishin zbatuar plotësisht; një ishin zbatuar pjesërisht, ndërsa pesë nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 2 - Mungesë e implementimit të plotë të rekomandimeve të 2012 - Prioritet i lartë

E gjetura Rekomandimet e pa adresuara ndërlidhen me fusha kyçe financiare, përshirë raportimin financiar dhe ekzekutimin e pagesave.

Rreziku Dështimi për t'i adresuar rekomandimet mbi sistemet kyçe financiare mund të rezultojë në:

- Dobësi të vazhdueshme në ekzekutimin e buxhetit;
- Dobësi në evidentimin e vonesave në përmbushjen e kontratave; dhe
- Kontrollë të dobëta në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Rekomandimi 2 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor për adresimin e rekomandimeve të AP me anëtarë të stafit përgjegjës të identifikuar, dhe me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Menaxhmenti në baza të rregullta.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe të rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit.

Menaxhmenti i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka monitoruar adresimin e rekomandimeve të dhëna në vitin 2012 dhe ka bërë një progres në këtë drejtim. Megjithatë, rekomandimet e pa adresuara vazhdojnë të kenë ndikim në fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Kjo paraqet nevojën për veprime shtesë, deri në adresimin e plotë për të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit ishin funksionale. Realizimi i buxhetit ishte në një nivel të arsyeshëm, në të gjitha kategoritë ekonomike.

Megjithatë, kontrollet mbi një serë fushash përfshirë menaxhimin dhe raportimin e shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm. Theks i veçantë, duhet të vihet klasifikimit të shpenzimeve sipas kategorive dhe raportimit të jashtëm.

Ndërsa nga aspekti i rëndësisë me të ulët kontrolle shtesë nevojiten në menaxhimin e procesit të pagesave si dhe në menaxhimin e personelit.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për ASHMDHP-në dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	372,000	381,594	371,101	281,001	134,456³
Granti i Qeverisë -Buxheti	372,000	372,000	361,811	281,001	134,456
Qeveria Norvegjeze	-	9,594	9,290	-	-

Nga të dhënat e prezantuara në tabelë shihet se ASHMDHP, nuk kishte ndryshime të dukshme në mes të buxhetit fillestar dhe final. Ndryshimi ishte vetëm në rritjen e buxhetit si rezultat i donacionit nga Qeveria Norvegjez në vlerë 9,594€.

Gjatë vitit 2013 ASHMDHP, kishin shfrytëzuar mbi 97% të buxhetit final. Krahasuar me realizimin e buxhetit të vitit 2012 (prej 94%), kishte një rritje prej 3%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve ne kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	372,000	381,594	371,101	281,001	134,456
Pagat dhe Mëditjet	160,000	160,000	159,772	141,724	55,684
Mallrat dhe Shërbimet	150,000	159,594	156,401	105,619	77,691
Shërbimet komunale	12,000	12,000	11,569	7,960	1,081
Investimet Kapitale	50,000	50,000	43,359	25,698	-

Realizimi i mirë i buxhetit ishte edhe sipas kategorive ekonomike. Buxheti në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte realizuar afro 100%, mallrat dhe shërbimet në 98% dhe shpenzimet komunale mbi 96%. Niveli paksa me të ulët i realizimit të buxhetit ishte te kategoria e investimeve kapitale në 87%.

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

³ Realizimi 2011 - Agjencia ka filluar të funksionoj si organizatë e pavarur në Qershor 2011

Trendi i shpenzimeve ndërmjet viteve është i ngjashëm dhe nxjerr në pah një nivel të vazhdueshëm dhe konsistent të ekzekutimit të buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë.

Megjithatë, të planifikimi dhe evidentimi i shpenzimeve në kodet adekuate ekonomike në kemi identifikuar çështjen në vijim:

Çështja 3 - Realizim i projektit kapital në kundërshtim me rregullat - Prioritet i lartë

E gjetura Në Programin e Investimeve Publike (PIP) ASHMDHP kishte paraparë një projekt kapital për blerjen e softuerit. Për këtë qëllim për vitin 2013 ishin të planifikuara 50,000€.

Në emër të këtij projekti, gjatë vitit 2013 ishte lidhur kontrata “Furnizimi më Kompjuter, fotokopje dhe pajisje tjera të IT-së” në vlerë 49,892€”. Prej tyre, 43,359€ janë paguar nga kategoria e investimeve kapitale.

Nga vlera e lartcekur e pagesave, vlera prej 16,400€ ishin pajisje më vlera më të ulëta se 1,000€ për njësi (Kompjuterë, Tabletë dhe pajisje tjera), andaj janë kategorizuar gabim në kategorinë e investimeve kapitale. Këto pajisje është dashur të planifikohen, realizohen dhe klasifikohen në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Rreziku Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve në kategori jo adekuate shkakton paqartësi në raportimin e shpenzimeve të ndodhura. Kjo ndikon në mbivlerësim e shpenzimeve në një kategori, kundrejt nënvlerësimit në kategorinë tjetër.

Rekomandimi 3 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të siguroj se me rastin e planifikimit të buxhetit, janë bërë analiza të hollësishme dhe janë identifikuar nevojat reale të shpenzimeve, përfshirë edhe kategorizimin e tyre. Me tutje, të siguroj se të gjitha shpenzimet janë regjistruara në kategoritë ekonomike adekuate.

4.3 Të hyrat vetanake (Donacionet/grandet e jashtme)

Përshkrimi

Në bazë të ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe rregullave tjera të brendshme ASHMDHP, mund të krijohet të hyra vetanake nga ofrimi i shërbimeve. Me një rregullore të brendshme kishte rregulluar edhe tarifatat për shërbimet e ofruara. Megjithatë gjatë vitit 2013, kjo agjenci nuk ka arritur të krijoj të hyra.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Meqë ASHMDHP, është organizatë e vogël, ajo kishte lidhur një marrëveshje me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, që procesi i prokurimit të kryhet nga Zyrtari i Prokurimit të Gjykatës Kushtetuese.

Gjatë vitit 2013, ASHMDHP ka nënshkruar 15 kontrata, ndërsa në disa raste ka shfrytëzuar edhe kontratat e Gjykatës Kushtetuese. Ne kemi testuar shtatë procedura të prokurimit dhe 29 pagesa përmes proceseve të prokurimit në vlerë 45,727€.

Bazuar në këtë vijmë në përfundim se procedurat e prokurimit janë zhvilluar në pajtueshmëri me kërkesat e LPP-së, më përjashtim të çështjes së identifikuar në vijim:

Çështja 4 - Kontraktimi i telefonisë mobile - Prioritet i mesëm

E gjetura	Gjatë vitit 2013, ASHMDHP kishte kontraktuar shërbimet e telefonisë mobile përmes sistemit me parapagim apo me fatura mujore (post-paid). Edhe përpos kësaj ata kishin vazhduar furnizimin më kartela mbushëse.
Rreziku	Mënyra aktuale e furnizimit me mbushje të telefonisë mobile nuk siguron shërbime efikase dhe ekonomike.
Rekomandimi 4	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të rishqyrtoj mundësinë e aplikimit të sistemit fatura mujore (post-paid). Kjo do të siguroj shërbime me efikase me kosto më të ulët.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne kemi testuar 27 pagesa në vlerë 59,684€ (pagesat për udhëtime jashtë vendit, komunalit dhe shërbime tjera). Gjatë testimeve të bëra kemi hasur në parregullsitë si në vijim:

Çështja 5 - Shpenzime të trajnimit përmes avanseve për udhëtime zyrtare - Prioritet i mesëm

E gjetura Gjatë vitit 2013, ASHMDHP kishte organizuar dy trajnime jashtë vendit me tema 'Menaxhimi efektiv në Institucione - menaxhimi i orientuar në rezultate' dhe 'Përgatitja për auditim për zyrat e financave, prokurimit, personelit dhe pasurisë'. Për organizimin e tyre ka kontraktuar një operator ekonomik i cili organizuar komplet trajnimet. Vlera e dy pagesave ishte 6,991€, përfshirë të gjitha shpenzimet e nevojshme (udhëtimin, fjetjen dhe ushqimin). Sipas rregullave të thesarit këto pagesa duhet të realizohen me procedura të rregullta përmes modulit të aprovimeve, mirëpo ASHMDHP i kishte realizuar me para të gatshme përmes mbylljes së avanseve.

Më tutje, sipas U.A. për udhëtime zyrtare "Nëse të gjitha shpenzimet janë të paguara nga donatori ose organizatori i trajnimit, personit që ka udhëtuar i paguhet 20% e mëditjes. Në rastet e lartcekura ASHMDHP, kishte qenë financuese e shpenzimeve të trajnimeve, andaj nuk lejohet pagesa e mëditjeve prej 20%. ASHMDHP, përpos shpenzimeve tjera ata kishin paguar nga 20% mëditje për stafin pjesëmarrës në vlerë totale 2,174€.

Rreziku Moszbatimi i procedurave të përcaktuara rrit rrezikun që paraja publike të përdoret në mënyrë të parregullt dhe të shkaktohen humbje financiare për Institucionin.

Rekomandimi 5 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të forcoj kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Ky proces duhet të bëhet në pajtim të plotë me rregulla të thesarit. Gjithashtu, mëditjet duhet të jepen në përputhje të plotë të udhëzimit administrativ për udhëtime zyrtare.

Çështja 6 - Pagesat për punë shtesë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas Ligjit të Buxhetit të Kosovës për vitin 2013, "Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra e shërbime, nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të mëditjeve apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat".

ASHMDHP me vendim të Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror kishte bërë pagesa për punë shtesë për zyrtarin e agjencisë për përkthim të dokumenteve. Vlera e pagesës ishte 1,200€ (gjashtë muaj nga 200€).

Rreziku Pagesat për shpenzimet të cilat janë të ndaluara me ligjin e buxhetit rrisin rrezikun për keqpërdorimin e parasë publike.

Rekomandimi 6 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të siguroj se gjatë fazës së përgatitjes së buxhetit janë identifikuar të gjitha nevojat për punë jashtë orarit. Me tutje, të forcoj kontrollet në menaxhimin e shpenzimeve për të siguruar se të gjitha pagesat bëhen në pajtim me Ligjin e buxhetit.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve për vitin 2013 ishte 160,000€. Prej tyre janë shpenzuar 159,772€ apo afro 100%.

Ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari (SIMFK) dhe prezantimin e tyre në PVF. Po ashtu kemi testuar mostra, duke përfshirë dosjet e personelit dhe procedurat e rekrutimit të realizuara gjatë vitit 2013. Bazuar në këtë, ne kemi konstatuar së ASHMDHP, ka të vendosur sisteme të mira të kontrollit mbi fushën e kompensimeve (pagave dhe mëditjeve), me përjashtim të çështjes së prezantuar në vijim.

Çështja 7 - Mbulimi i pozitave menaxhuese me ushtrues detyre - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas Ligjit të Shërbimit Civil, në rast të mbetjes së një pozitë të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet me gjatë se tre muaj.
- ASHMDHP, me organogramin dhe udhëzimin e ri për organizimin e brendshëm të institucionit, kishte paraparë edhe pozitën e drejtorit të përgjithshëm. Kjo pozitë nga shtatori i vitit 2013 e deri në kohën sa ishim në auditim (maj 2014), përafërsisht nëntë muaj menaxhohet me ushtrues detyre.
- Rreziku** Mbajtja e pozitave kyçe si ushtrues detyre për një kohë të gjatë, rrezikon në humbjen e ndjenjës së përgjegjësisë së këtyre zyrtarëve, për të arritur objektivat e përcaktuara.
- Rekomandimi 7** Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të siguroj se janë iniciuar procedurat e rekrutimit për të mbuluar pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Sipas regjistrit kontabël (SIMFK) vlera neto e pasurive të ASHMDHP-së ishte 45,022€, ndërsa pasuria jo-kapitale me vlerë nën 1,000€ ishte 40,034€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Bazuar në këtë ne identifikuam mangësitë si në vijim:

Çështja 8 - Regjistrat e pasurisë nuk ishin të plotë - Prioritet i lartë

E gjetura ASHMDHP, edhe përkundër kërkesave të vazhdueshme, ende nuk e kishte në funksion programin qeveritar E-pasuria. Në mungesë të këtij programi, regjistri i pasurisë më vlerë nën 1,000€ është mbajtur në Excel.

Ndërsa regjistri kontabël i pasurisë (SIMFK) nuk ishte i plotë. Në këtë regjister nuk ishin përfshirë pajisjet e TI në vlerë 27,061€, të cilat ishin blerë në fund të vitit 2013. Megjithatë kjo vlerë është shpallur në PVF.

Rreziku Në mungesë të regjistratit E-pasuria, informatat e prezantuara nuk do të jenë në përputhje me formatet standarde të kërkuara, andaj të dhënat e prezantuara mund të jenë konfuze. Gjithashtu, në mungesë të regjistrave të plotë të pasurisë ekziston rreziku për humbjen ose keqpërdorimin e tyre.

Rekomandimi 8 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet sigurojë kontrollë shtesë mbi menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, përfshirë azhurnimin e vazhdueshëm të regjistratit kontabël të pasurisë si dhe funksionalizimin e programit E-pasuria.

4.5.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrimi

Pasqyra e detyrimeve të papaguara e shpallur në PVF në fund të vitit 2013 ishte në vlerën 8,475€. Këto obligime janë bartur për pagesë në vitin 2014.

Ne gjithashtu kemi rishikuar nëse obligimet e mbetura në fund të vitit 2013 janë paguar në fillim të vitit 2014. Ne vërejtëm se këto obligimet janë paguar në fillim të këtij viti.

ASHMDHP nuk kishte raportuar në MF raportet mbi obligimet e papaguara. Për me tepër referoju kapitullit 2.4. Pajtueshmëria me kërkesat tjera për raportim të jashtëm.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Në bazë të kërkesave të udhëzimit administrativ nr.23/2009, për themelimin dhe funksionimin e Njesisë së auditimit të brendshëm (NJAB) në sektorin publik, ASHMDHP nuk i plotëson kriteret për të themeluar këtë njësi.

Megjithatë, gjatë vitit 2013 agjencia kishte kërkuar nga NJAB në kuadër të MF-së të realizojnë shërbimet e auditimit të brendshëm. Bazuar në këtë kjo njësi kishte realizuar një auditim të brendshëm me temë "Funksionimi i Administratës".

Ne e kemi analizuar këtë raport dhe kemi vërejtur se raporti ishte i cilësisë së duhur, dhe përmbante konkluzione dhe rekomandime të dobishme për menaxhmentin e ASHMDHP-së.

Pas pranimit të raporteve të auditimit të brendshëm, menaxhmenti ishte në proces për të adresuar çështjet e ngritura në këtë raport.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;

Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2.2. Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare	Të sigurojë që plani i prodhimit për PVF-të 2013 formalisht përfshin rishikimin menaxherial të draft pasqyrave.			Nuk janë marrë masa.
2.2. Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare	Ne të ardhmen në rast të korrigjimeve të tilla, të bëjë shpalosjet e duhura lidhur me shpenzimet reale të pagave dhe mëditjeve.	Po		
4.2. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Të rishqyrtoj proceset ekzistuese buxhetore për të siguruar përmirësimin e planifikimit dhe dinamikën e realizimit të buxhetit. Si pjesë e këtij procesi, duhet të siguroj që rrjedha e parasë është përgatitur duke u bazuar në buxhetin fillestarë të aprovuar dhe po ashtu dinamika e shpenzimit është planifikuar duke u bazuar në nevojat e Agjencisë për gjatë tërë vitit. Më tutje, Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të marr në konsideratë implikimet buxhetore që mund të pasojnë nga aprovimi i vendimeve menaxheriale.		ASHMDHP, kishte përmirësuar menaxhimin e buxhetit, mirëpo edhe me tutje disa vendime nuk ishin në nivelin e duhur.	

4.3. Kërkesat e raportimit	Pavarësisht faktit që procedurat udhëhiqen nga një autoritet tjetër, duhet të përgatit planin fillestar dhe përfundimtar të prokurimit me qëllim të identifikimit të furnizimeve gjatë vitit. Kjo njëherit do t'a lehtësonte bashkëpunimin mes Agjencisë dhe autoritetit i cili kryen procedurat e prokurimit.	Po		
4.3. Kërkesat e raportimit	Të siguroj që ka instaluar mekanizma monitorues për të siguruar që sektori i financave përgatit raporte mujore mbi borxhet e Agjencisë dhe të njëjtat dërgohen në MF në baza mujore.			Nuk janë marrë masa.
4.3. Kërkesat e raportimit	Të përgatiten raportet për vetëvlerësimin dhe kontrole të brendshme për të vlerësuar efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.			Nuk janë marrë masa.
4.4.1. Prokurimi	Të sigurojë që procedurat e reviduara janë futur për të siguruar që kontrollet janë shtuar në kuadër të sektorit të pagesave në mënyrë që shpenzimet të klasifikohen dhe regjistrohen në përputhje me planin kontabël të miratuar.			Nuk janë marrë masa.
4.4.2. Shpenzimet tjera	Të rishikoj arsyet për mos mbylljen e avansit dhe të ndërmer masa konkrete që paratë e shpenzuara janë arsyetuar me dokumente përkatëse dhe procedurat e duhura për mbyllje janë kryer.	Po		
4.4.2. Shpenzimet tjera	Të shqyrtoj mundësin e zhvillimit të procedurave të prokurimit në mënyrë që të siguroj shërbime efikase me çmime më të favorshme.	Po		

4.4.3. Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Të ndërmarr masat konkrete për plotësimin e vendeve të lira për të mundësuar funksionimin e plotë të Agjencisë.	Po		
4.4.3. Kompensimet (Pagat dhe mëditjet)	Puna jashtë orarit të llogaritet sipas ligjit për pagat e nëpunësve civil.	Po		
4.6. Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Të ndërmerr hapat konkret për certifikimin e zyrtarit të pasurisë me qëllim që pasuritë mbi 1,000€ të regjistrohen në regjistrin kontabël (SIMFK).	Po		
4.7. Trajtimi i borxheve	Paraprakisht, të siguroj që ka buxhet të mjaftueshëm dhe më pas të hyj në obligime, njëherit faturat t'i paguaj brenda 30 ditëve pas pranimin të faturës.			Nuk janë marrë masa.
5. Sistemi i auditimit të brendshëm	Ka marr në konsideratë lidhjen e një marrëveshje me ndonjë institucion të pavarur për shfrytëzimin e shërbimeve të Auditimit të brendshëm.	Po		